




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Nr. I faq.	
Broj stranica	<u>02</u>
Nr. pages	
Nr. Prot.	<u>01-1163/15</u>
Br.Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	<u>16.04.2015</u>
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 15.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-4502-15 për z. *Avdullah Hoxha – Këshilltar Komunal* në *Kuvendin e Ferizajt* dhe *Zyrtar kryesor financiar* në *Ndërrmarrjen publike KRU “Bifurkacioni” sh.a.*, për shkak se z. *Hoxha*, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit, është liruar nga funksioni menaxhues-zyrtar kryesor financiar në *Ndërrmarrjen publike KRU “Bifurkacioni” sh.a. Ferizaj*, për tu sistemuar në një pozitë tjetër (jo menaxhuese).

Tani z. *Hoxha*, si zyrtar i lartë publik e ushtron vetëm funksionin e *Këshilltar komunal* në *Kuvendin e Ferizajt*.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur pas një lajmërimi - Kërkesë për iniciimin e procedurave nen dyshimin për Konflikt interesë në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4502-14, për Zyrtarin e lartë, z. Avdullah Hoxha – Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajt, dhe njëkohësisht Zyrtar financiar ne Ndërrmarrjen publike KRUK “Bifurkacioni”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokolli i AKK-03-4502-15, të dyshuar për konflikt interesë në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrimit, kemi kontaktuar me z. Hoxha i cili ka konfirmuar se njëkohësisht kryen funksionin edhe si Këshilltar Komunal në Kuvendin e Ferizajt, por edhe si Zyrtar kryesor financiar në Ndërrmarrjen komunale “Bifurkacioni” në Ferizaj.

Duke qenë se me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike; Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në

organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, ne kemi kërkuar nga z.Hoxha që të bëjë shhangjen e kësaj situate të konflikti të interesit.

Z.Hoxha edhe përkundër premtimit se do të bëjë një ndryshim duke u përcaktuar për njërin nga këto funksione këtë nuk e ka bërë brenda afatit të parë të caktuar prandaj AKK i ka bërë edhe shkresën e dytë Paralajmëruese me afat të kufizuar për të zgjedhur se cilin nga këto funksione do të ushtroj.

Ndërkohë, z.Avdullah Hoxha, në Agjencinë kundër Korrupsion ka sjell Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale “Bifurkacioni” sh.a. Ferizaj, në të cilin shihet se ai është liruar nga pozita e menaxherit –zyrtarit kryesor financiar në KRU “Bifurkacioni”.

Bordi i Drejtorëve me këtë vendim ka urdhëruar Kryeshefin ekzekutiv të kësaj Kompanie që z.Hoxha ta sistemoj në një pozitë tjetër.

Me këtë Vendim (DPK-DPKI-03-02-1028/15), Agjencia kundër Korrupsion konstaton se është shhangur situata me konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, sepse tanë z.Hoxha ushtron vetëm një funksion të zyrtarit të lartë publik si Këshilltar Komunal në Kuvendin komunal të Ferizajt.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

